



Numri i lëndës: KSC-BC-2020-05
Prokurori kundër Salih Mustafës

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatësi Nikola Giju

Administratore Dr. Fidelma Donlon

Data: 7 maj 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për Kalimin e Dosjes së Çështjes Gjyqësore Trupit Gjykues I

Trupit Gjykues I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Vladimir Mikula (gjykatës rezervë)

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të të akuzuarit

Julius von Bone

Mbrojtëses së viktimave

Ani Pues

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të rregullës 98(1) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon vendimin e mëposhtëm:

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 12 qershor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën kundër Salih Mustafës (“z. Mustafa”).² Më 24 shtator 2020, z. Mustafa u arrestua në bazë të vendimit³ dhe të fletarrestimit të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.⁴
2. Më 5 mars 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i informoi palët se kalimi i dosjes së çështjes gjyqësore Trupit Gjykues parashikohet të bëhet të premten, më 7 maj 2021, ose rreth asaj date, në varësi të zgjidhjes së aspekteve ende të patrajtuara.⁵
3. Më 5 maj 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake njoftoi Kryetaren e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”) se dosja e plotë e kësaj çështjeje gjyqësore sipas rregullës 98(3) të Rregullores do të jetë gati për t’iu kaluar Trupit Gjykues të premten, më 7 maj 2021.⁶
4. Më 5 maj 2021, Kryetarja caktoi gjykatësit Roland Dekers, Mapi Feld-Folia, Zhilber Biti, dhe Vladimir Mikula (gjykatës rezervë) si gjykatës të Trupit Gjykues I.⁷

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-05, F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Konfirmimin e Aktakuzës kundër Salih Mustafës*, 12 qershor 2020, rreptësishtë konfidencial dhe *ex parte*. Versioni publik i redaktuar u protokollua më 5 tetor 2020, F00008/RED.

³ KSC-BC-2020-05, F00009/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimit dhe Urdhrit të Transferimit*, 12 qershor 2020, publik.

⁴ KSC-BC-2020-05, F00009/A01/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Fletarrestimit për z. Salih Mustafa*, 12 qershor 2020, publik.

⁵ KSC-BC-2020-05, Transkripti, 5 mars 2021, konfidencial, f. 203, rreshtat 4-6.

⁶ KSC-BC-2020-05, F00112, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Njoftim sipas Rregullës 98(3) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës*, 5 maj 2021, publik.

⁷ KSC-BC-2020-05, F00114, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Trupit Gjykues I*, 5 maj 2021, publik.

5. Më 7 maj 2021, në pajtim me pjesët 12(2) dhe 15 të Direktivës për Mbrojtësit dhe rregullës 13 të Rregullores së Ndihmës Juridike, Administratorja caktoi⁸ Ani Pues për të përfaqësuar pesë viktimat pjesëmarrëse në procesin gjyqësor.⁹

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Në pajtim me rregullën 98(1) të Rregullores, pas marrjes së dosjeve paraprake përkatëse nga Prokurori i Specializuar dhe Mbrojtja bazuar në rregullën 95(4) dhe (5) të Rregullores, gjykatësi i procedurës paraprake i kalon trupit gjykues dosjen e plotë të çështjes gjyqësore, e cila përmban:

- (a) Aktakuzën e Konfirmuar;
- (b) të gjitha parashtrimet dhe materialet e dorëzuara nëpërmjet sistemit elektronik të administrimit gjyqësor;
- (c) çfarëdo provash të administruara që nuk përmenden në paragrafin (1)(b);
- (d) çfarëdo letërkëmbimi në lidhje me çështjen që nuk është dorëzuar në Njësinë e Administrimit të Gjykatës;
- (e) një dokument dorëzues që përfshin:
 - (i). argumentet e palëve dhe nëse është e zbatueshme, të Mbrojtëses së Viktimave, në lidhje me faktet dhe ligjin përkatës;
 - (ii). pikat për të cilat palët pajtohen;

⁸ KSC-BC-2020-05, F00117, Administratorja, *Njoftim për Caktimin e Mbrojtësit të Viktimave për Grupin 1 të Viktimave Pjesëmarrëse në Proces*, 7 maj 2021, publik, me një shtojcë, konfidenciale dhe *ex parte*.

⁹ KSC-BC-2020-05, F00105/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Versioni i Redaktuar Publik i Vendimit të Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave*, 30 prill 2021, publik.

- (iii). listën e urdhrave dhe vendimeve të dhëna nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake;
 - (iv). provat e paraqitura nga secila palë;
 - (v). sugjerime në lidhje me numrin dhe rëndësinë e dëshmitarëve që do të thirren;
 - (vi). pikat e kundërshtuara faktike dhe ligjore;
 - (vii). ecurinë e nxjerrjes së materialeve;
 - (viii). të gjitha mbledhjet me palët; dhe
 - (ix). çfarëdo çështje tjetër të pazgjidhur;
- (f) kërkesa dhe vendime në lidhje me nxjerrjen e materialit; dhe
- (g) çfarëdo materiali tjetër që ka lidhje me çështjen.

7. Në pajtim me rregullën 98(2) të Rregullores, kalimi i dosjes së çështjes gjyqësore kryhet në mënyrë elektronike.

III. DISKUTIM

8. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se janë kryer të gjithë hapat e nevojshëm proceduralë për ta konsideruar dosjen e çështjes gjyqësore KSC-BC-2020-05 të plotë dhe, për rrjedhojë, gati për t'iu kaluar Trupit Gjyqësor I, në pajtim me rregullën 98 të Rregullores.

9. Konkretisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka përgatitur dokumentin dorëzues, që përmban informacionin e përshkruar në rregullën 98(1)(e) të Rregullores, për Trupin Gjyqësor dhe palët. Gjykatësi i Procedurës Paraprake saktëson se, për shkak të

informacionit jopublik që përmban dokumenti dorëzues, ai nuk mund të bëhet publik në këtë fazë. Dokumenti dorëzues i bashkëlidhet këtij vendimi.

IV. VENDIM

10. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia **KALON** dosjen e çështjes gjyqësore KSC-BC-2020-05 Trupit Gjyqësor I, së bashku me dokumentin dorëzues bashkëlidhur këtij vendimi.

/nënshkrimi/

Gjykatësi Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E premte, 7 maj 2020

Në Hagë, Holandë.